

Mbështetje për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe lehtësimin e zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në Shqipëri

Cili është qëllimi?

- ▶ Të mbështesë institucionet shqiptare në fushën e drejtësisë për të zbatuar me efektshmëri dhe në kohë vendimet gjyqësore të brendshme si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ▶ Të sigurojë që e drejta e pronësisë në Shqipëri të zbatohet me efektshmëri;
- ▶ Të ofrojë asistencë në harmonizimin e praktikave gjyqësore në fushën e të drejtës së pronësisë.

Kush është përfitues i projektit?

- ▶ Qytetarët e Shqipërisë dhe vecanërisht gratë dhe vajzat në lidhje me të drejtën për gëzimin paqësor të pronës;
- ▶ Institucionet publike kryesisht Avokatura e Shtetit, Agjensia e Trajtitit të Pronave, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Parlamenti Shqiptar, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Universitetet.

Si do të punojë projekti?

- ▶ Duke identifikuar sfidat e lidhura me zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së, projekti do të propozojë dhe mbështesë zbatimin e mjeteve efektive për të përmirësuar kuptimin e vendimeve përfundimare, vendimeve të GjEDNj-së dhe gjithashtu do të mbështesë institucionet në zbatimin e tyre;
- ▶ Duke hartuar rekomandime të rëndësishme dhe duke mbështetur institucionet për një funksionim më efektiv dhe të shpejtë të kuadrit ligjor mbi të drejtën e pronësisë, si psh. mekanizmi i kompensimit dhe mbështetja për zbatimin e tij;
- ▶ Duke organizuar takime ndërgjyqësore dhe shkëmbime përvojash, projekti do t'i mundësojë profesionistëve në fushën e ligjit të përmirësojnë harmonizimin e standarteve të Konventës në praktikën gjyqësore vendase.

Cilat janë rezultatet e pritshme?

- ▶ Zbatim më me efektshëri të mjeteve të brendshme efektive për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe zbatimin e vendimeve të brendshme;
- ▶ Funksionim me efektshmëri të instrumentave ligjor relevant si psh mekanizmi i kompensimit të pronës të jetë në përputhje me jurisprudencën dhe standartet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut;
- ▶ Përmirësimi i kuptueshmërisë ligjore dhe sigurisë së qytetarëve që kërkojnë shërbime ligjore nëpërmjet zbatimit të qëndrueshëm të legjislacionit dhe dialogut të përforcuar ndërgjyqësor veçanërisht në fushën e të drejtës së pronësisë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Cili është buxheti i projektit?

- ▶ Buxheti total i projektit është 700 000 euro;
- ▶ Buxheti i përgjithshëm i alokuar për programin e Instrumentit Horizontal, është 41 milion euro (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës).

Ku mund të merrni informacion?

- ▶ Departamenti i Zbatimit të të Drejtave të Njeriut:
<https://www.coe.int/en/web/national-implementation/home>
- ▶ Marjana Papa, Oficere e Projektit, Marjana.PAPA@coe.int
- ▶ Faqja e Internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Marija Simić, Oficere Rajonale e Komunikimit për Instrumentit Horizontal, Marija.SIMIC@coe.int, +381 63 601 337
- Besnik Baka, Oficer komunikimi për Instrumentin Horizontal, Besnik.Baka@coe.int, +355 69 217 8430

Rreth Programit Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

Programi i mbështetjes Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022” është një nismë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që i mundëson përfituesve të përshtasin axhendat e reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës, demokracisë si dhe të përmbushin standartet evropiane duke përfshirë ato standarte brenda kuadrit të procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre vjeçar pëfshin projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbi, si edhe Kosovë* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës që nga Maji i vitit 2019.

**Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës*

Këshilli i Evropës është organizata lider e të Drejtave të Njeriut e cila përbëhet nga 47 vende anëtare duke përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës kanë ratifikuar Konvetën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin njohurinë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm teksa ruajnë diversitetin kulturor, tolerancën dhe lirinë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Kjo fletëpalosje u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY 2019-2022

FOR YOUR RIGHTS: TOWARDS EUROPEAN STANDARDS

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës